

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparim Automjesh”, në 2 LOT-e:

- ✚ **LOT 1** “Shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”;
- ✚ **LOT 2** “Riparim dhe mirëmbajtje të autoambulancave në administrim të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50112110-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 12.567.043 (Dymbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyzet e tre) **Lekë pa TVSH**, ndarë në 2 (dy) lotet si me poshtë:

- ✚ **LOT 1- 5.567.043** (Pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyzet e tre) **Lekë pa TVSH**,
- ✚ **LOT 2- 7. 000. 000** (Shtatë million) **Lekë pa TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (per te dy lotet)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me **Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç,** në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Në lidhje me kete te paraqitet Licenca e vlefshme ne emer te OE.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) apo disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Kapaciteti profesional i OE i shërben AK për të vërtetuar se plotësohen kushtet ligjore, profesionale që një OE të marrë pjesë në një procedurë prokurimi, Në rastin konkret, objekti i prokurimit është i lidhur ngushtë me një ambient ku do të zhvillohet procesi i diagnostifikimit dhe riparimi i defekteve te automjeteve apo do të kryhet zëvendësimi i pjesëve të nevojshme për këmbim apo ndërrim. Vetë legjislacioni i fushës ka rregulluar këtë veprimtari me anë të licensimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit (te dy lotet)** . Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021, me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit (për secilin lot). Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Eshtë kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit pasi fondi limit për çdo lot është nën kufirin e ulet monetar dhe është pershtatur kërkesa me ato të procedurës e hapur e thjeshtuar. Shumatorja e dy fondeve limit kalon në fond midis kufirit të ulet dhe të lartë monetar, pra procedure të hapur.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të posedojnë një Repart për bojatisjen e mjeteve për të cilin të jenë të pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në lidhje me kete të paraqitet Licenca perkatëse dhe dokumenti i pronësise së objektit, Në rast objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata perkatëse.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM

Nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) apo disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". Meqenëse në specifikimet teknike të dy loteve ka zera të cilët kanë të bëjnë me bojatisjen, shihet e arsyeshme të vendoset ky kriter. Ambientet ku ushtrohet kjo veprimtari, sipas ligjit duhet të jenë të pajisur me licence mjedisore si pasoje e efekteve që kanë në mjedis gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë të paktën 6 (gjashtë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) Inxhinier mekanik/ mekanik transporti, në detyrën/rolin e drejtuesit Teknik.
- b) 1 (një) motorist,
- c) 2 (dy) xhenerikë,
- d) 1 (një) elektroauto,
- e) 1 (një) bojaxhi.

Për të vertetuar sa më sipër për secilin prej punonjësve duhet të paraqesin:

- a) Për inxhinierin mekanik, **drejtues teknik** duhet të paraqitet kontrata e punës ku të cilesohet ky pozicion dhe Diploma.
- b) Për punonjësit e tjerë, të paraqitet kontrata e punës ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, elektroauto ose bojaxhi dhe deshmite perkatëse profesionale.

2.3.3.1 Gjatë fazës së ofertimit, në plotësim të këtij kriteri, OE duhet të plotësojnë formularin e Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9, më tej, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afatëve të ankimit operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e vlefshëm, të sipër cituar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirmbajtje të automjeteve, drejtuesi teknik i kompanisë do të luajë një rol kryesor në zbatimin e kësaj marreveshjeje kuader. Gjithashtu nevoja për riparime të mundshme të agregatit të motorit, të karrocërës, të sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj kërkon pasjen e një stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut, bojaxhi e vertetuar kjo në baze të kontratave të punës dhe deshmive profesionale. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisje dhe instrumente të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjencës) së rrotave të mjetit, të paktën 1(një) copë;
- b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo);

- c) pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete, të paktën 1 (një) copë;
- d) pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C;
- e) Pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit.
- f) pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v;
- g) pajisje urë ngritese për automjetet, të paktën 2 (dy) ura për mjetet objekt prokurimi.
- h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit;
- i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;
- j) pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- k) pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit;
- l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.

2.3.4.1 Gjatë fazës së ofertimit, në plotësim të këtij kriteri, OE duhet të plotësojnë formularin e Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9, më tej, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, ku një pjesë e tyre mund të ofrohet nga OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht ambientin e prodhimit, makineritë, pajisjet, asetet e nevojshme të përcaktuara më sipër si dhe kapacitetet njerëzore, stafin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale me qëllim realizimin të objektit të prokurimit. Ndërkohe jo vetëm kaq, por specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e riparimit të kërkuara në Shtojcën 6 (Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit). Përfundimisht, nisur nga faktorët e mësipërm si dhe nga eksperiencia e punës që kemi në fushën e autoriparimit, theksojmë që numri i kërkuar më sipër nga ana jone për pajisjet është minimal dhe kjo është bërë në përputhje me LPP-ën dhe VKM-ës, për të bërë të mundur kështu pjesëmarrjen e gjerë të OE në realizimin e kësaj procedure prokurimi.*

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë të paktën 1 (një) karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara.

2.3.5.1 Gjatë fazës së ofertimit, në plotësim të këtij kriteri, OE duhet të plotësojnë formularin e Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9, më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) si dhe lejen e qarkullimit të mjetit.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, nder të cilat*

mund të ndodh që në rastet e caktuara duhet të transportojnë një automjet të difektuar në ambientet e servisit që disponon OE, është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) automjet, konkretisht karrotrec me qëllim realizimin të objektit të prokurimit. Kerkohet të vertetohet disponimi me ane të pronësive apo kontrates së qirase apo përdorimit si dhe me ane të lejes së qarkullimit do të identifikohet kapaciteti mbajtes, targa, etj.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Kjo marreveshje kuader, përveç shërbimit, si element thelbësor ka dhe mallrat objekt prokurimi, pra pjesët rezerve apo agregatet që do t'i vendosen automjeteve. Me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen të jenë të rinj dhe me garanci nga prodhuesi dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.3.7 Në lidhje me Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimeve të percaktuara në shtojcën 6, Formulari i Shërbimeve dhe Grafiku i Ekzekutimit, OE duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga një organ i akredituar.

Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit			
Nr.	Emërtimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
2			

Argumentimi: Me ane të tabelës kerkohet që AK të ketë dijeni për mallrat objekt prokurimi nga do të sigurohen dhe të jenë cilësore dhe me kushtet sipas garancisë së prodhuesit. Kerkohet që mallrat të jenë të cilësive CE ose ekuivalent për shkak të rëndësive së automjeteve të cilat janë automjete të një institucioni ekzekutiv, të një rëndësie të vecante sic është Ministria dhe në lotin 2, janë autoambulanca të cilat shërbejnë për të transportuar pacientë të sëmurë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratatë të rreme, të praqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Shënim: Kriteret e vecante për të dy lotet janë të njëjta ndaj argumentimi i çdo kriteri, është i njëjti.

Operatorët ekonomikë të cilët duan të marrin pjesë në të dy lotet duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative kriteret ekonomike-financiare dhe ato të kontratave të ngjashme, pra duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e

xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit te te dy loteve dhe** duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 e % e vlerës së fondit limit te te dy loteve.

***Argumentim:** Kur OE duan te konkurojne per te dy lotet, vlera e fondit limit kalon ne perzgjedhjen e procedures se prokurimit publik ne procedure te hapur, ndaj kerkesa per deshmi te meparshme, te ngjashme behet 39 %.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoritetet Kontraktore **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, per LOT 1 dhe nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec** per Lot 2, për nevojat e së cileve, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh. a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: **19/06.2024**; Ora: **11:00**; Vendi: **www.app.gov.al**, Operatori i Blerjeve te Përqëndruara, Tiranë.

NJESIA E PROKURIMIT